

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën në organet e administratës shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikë së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), si dhe në bazë të nenit 22 dhe 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/ 2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 30/2016, 67/2017 dhe 64/2018, Ministri i Arsimit dhe Shkencës solli **programin mësimor modular të shkurtuar për lëndën mësimore Gjeografi për vitin I në arsimin e mesëm profesional katërvjeçar (drejtimi Hoteleri-turizëm) për vitin shkollor 2020/2021.**

1. Hyrje

Programi mësimor modular i shkurtuar për lëndën mësimore **Gjeografi për vitin I në arsimin e mesëm profesional katërvjeçar (drejtimi Hoteleri-turizëm)** bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura të parapara me programin mësimor që realizohet rregullisht sipas planit mësimor të përcaktuar.

Me këtë program mësimor modular të shkurtuar përcaktohen njësitë mësimore modulare dhe përmbajtje mësimore të caktuara, që duhet të realizohen në **159 ditë** mësimdhënie, duke respektuar fondin e planifikuar javor të orëve mësimore të përcaktuara në programin e rregullt, domethënë, për një lëndë me **2 orë** në javë, në programin e shkurtuar janë parashikuar **64 orë** mësimore në vit.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive dhe përmbajtjeve mësimore modulare nga programi i shkurtuar mësimor udhëhiqet nga qëllimet, rezultatet e pritura, konceptet, veprimtaritë dhe metodat e përcaktuara në programin modular të rregullt mësimor.

2. Pasqyrë e temave dhe përmbajtjeve mësimore

Në programin mësimor modular të shkurtuar janë paraparë **37 orë** për realizimin e përmbajtjeve të reja mësimore dhe **27 orë** për përsëritje, përforcim dhe sistematizim të të arriturave.

Njësitë/temat modulare

Njësia modulare I: SISTEMI I INFORMACIONIT GJEOGRAFIK- (5+4 orë) (5 orë realizim të njësive të reja, 4 orë përsëritje dhe përforcim)

Përmbajtjet mësimore:

- Hyrje - Elementet në sistemin e informacionit gjeografik;
- Elementet në sistemin e informacionit gjeografik;
- Leximi i hartës gjeografike;
- Leximi i hartës gjeografike digjitale;
- Leximi i atlasit digjital gjeografik.

Njësia modulare II: KARAKTERISTIKAT RAJONALE DHE FIZIKE TË TOKËS - (11+8 orë)

Përmbajtjet mësimore:

- Pozicioni gjeografik, kufijtë dhe përthyerja bregdetare e kontinenteve;
- Kontrastet e relievit të Tokës;
- Dukuritë ekstreme klimatike të Tokës;
- Shpërndarja e pabarabartë e ujrave të ëmbla në Tokë;
- Ndotja e mjedisit një problem akut i njerëzimit;
- Mbipopullimi, problem i shumë vendeve në botë;
- Nevojat dhe problemet energjetike në Tokë;
- Globalizimi si problem botëror;
- Komunikacioni botëror;
- Tregtia botërore;
- Turizmi botëror.

Njësia modulare III: KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE TË EVROPËS - (11+8 orë)

Përmbajtjet mësimore:

- Pozicioni gjeografik, kufijtë dhe përthyerja bregdetare;
- Karakteristikat e relievit;
- Klima;
- Vegjetacioni;
- Hidrografia;
- Popullsia dhe vendbanimet;
- Pasuritë minerale dhe burimet energjetike;
- Karakteristikat ekonomike të Evropës;
- Komunikacioni në Evropë;
- Tregtia;
- Turizmi;

Njësia modulare IV: KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT - (10+7 orë)

Përmbajtjet mësimore:

- Pozita gjeografik, kufijtë dhe madhësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Relievi;
- Karakteristikat klimatike;
- Hidrografia;
- Bota bimë dhe shtazore;
- Popullsia dhe vendbanimet;
- Bujqësia dhe degët saj;
- Burimet energjetike dhe pasuritë minerale;
- Industria;
- Veprimtaritë shërbyese (komunikacioni, tregtia dhe turizmi).

3. Rekomandimet didaktike

Planifikimi i orës mësimore nga lënda Gjeografi për vitin I të arsimit profesional katërvjeçar, që është paraparë me këtë program të shkurtuar mësimor, përfshin përmbajtjet programore të 4 njësive modulare të caktuara në programin mësimor modular të rregullt. Për secilën njësi modulare është paraparë numër i caktuar i orëve mësimore, me qëllim që të përvetësohen përmbajtjet më kryesore nga programi mësimor i lëndës së gjeografisë për vitin I të arsimit profesional katërvjeçar dhe të njejtat të realizohen për 64 orë në kohëzgjatje prej 159 ditë.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të përmbajtjeve mësimore nga programi i shkurtuar modular udhëhiqet nga qëllimet, rezultatet e pritura, konceptet, veprimtaritë dhe metodat e përcaktuara në programin mësimor modular të rregullt, por për të njejtat parashtron pyetje dhe detyra nga nivele të ndryshme vështirësie, udhëhequr gjithmonë nga propozim-aktivitetet duke i plotësuar ato sipas nevojave të nxënësve.

Në këtë program mësimor modular të shkurtuar është dhënë propozim për planifikimin e orëve mësimore për të realizuar përmbajtjet mësimore modulare dhe qëllimet e tyre. Sidoqoftë, mësimdhënësi duhet të planifikojë në mënyrë të pavarur fondin e orëve për realizim të plotë dhe të suksesshëm të qëllimeve të vendosura në programin mësimor modular. Duke pasur

parasyshtë që përbërja e nxënësve në klasa është heterogjene, mësimdhënësit duhet të praktikojnë qasje të diferencuar dhe të individualizuar brenda realizimit të mësimdhënies. Qasje e tillë është në funksion të nevojave specifike individuale të secilit nxënës si dhe zhvillimit të potencialeve dhe arritjeve individuale.

Në programin mësimor modular të shkurtuar për lëndën mësimore **Gjeografi për vitin I në arsimin e mesëm profesional katërvjeçar**, disa përmbajtje mësimore mungojnë, disa janë kapërcyer ose janë shkurtuar e disa të tjera janë ndërlidhur. Zakonisht, janë ato përmbajtje mësimore që nxënësit i kanë hasur në vitet paraprake ose që do t'i hasin në vitet në vijim. Kjo është bërë me qëllim të realizimit papengesa të këtij program modular të shkurtuar.

Rekomandohet përdorimi i mjeteve mësimore vijuese:

- libër shkollor i zgjedhur në nivelin e shkollës për lëndën përkatëse i miratuar nga ministria;
- burime të tjera të të mësuarit të gjendura në afërsi - objekte dhe fenomene natyrore;
- enciklopedi të ndryshme, atlase, etj;
- Internet, softuere të ndryshme arsimore;
- revista;
- mjete audio-vizuale.

Teknologjia moderne didaktike e të mësuarit të gjeografisë përveç përdorimit të hartave të ndryshme, jep mundësi të jashtëzakonshme për përdorim të kompjuterin, gjegjësisht, zbatim të gjerë të gjeoinformatikës në mësimdhënien e kësaj lënde. Gjithashtu, në mësimdhënie mund të përdoren edhe hartat memece dhe harta tjera të ndryshme, literaturë gjeografike, doracak për mësimdhënie, etj. Konceptet e reja të mësuara do të paraqesin azhurnim dhe zgjerim të koncepteve tashmë të mësuara. Gjatë interpretimit dhe përshkrimit që bëjnë nxënësit, është i nevojshëm inkurajimi nga mësimdhënësi në mënyrën që i përshtatet karakteristikave individuale të nxënësit. Të shprehurit mund të jetë edhe përmes: të folurit, esesë, metodave ilustruese, përpunimt të skemave, grafikëve, etj. Përdorimi i emrave dhe të dhënave shifrore duhet të thjeshtëzohen në një nivel të arsyeshëm. Gjatë mësimdhënies, vazhdimisht përcjellen dhe vlerësohen arritjet e nxënëve, mblidhen treguesit për aktivitetet e tyre, motivimi për të mësuar, bashkëpunimi me të tjerët, etj. (vlerësimi formativ). Rekomandohet të përdoren mënyrat vijuese për përcjelljen, kontrollimin dhe vlerësimin e të arriturave të nxënësve në kuadër të temave mësimore modulare: gojarisht, me shkrim, në praktikë (përpyetje, ushtrime dhe ngjashëm), puna në grupe, pjesëmarrje në hulumtim dhe prezantim.

4. Normativi për kuadrin mësimor

Programin mësimor modular të shkurtuar e realizon mësimdhënësi në përputhje me normativin për kuadrin mësimor nga programi mësimor modular i rregullt.

Programin mësimor modular të shkurtuar për lëndën mësimore **Gjeografi për vitin I në arsimin e mesëm profesional katërvjeçar (drejtimi Hoteleri-turizëm)** për vitin shkollor 2020/2021 e miratoi

Ministër
Mila Carovska
